



Skuadra kuqeblu ka arritur të fitojë me rezultatin 1-0 ndeshjen e kthimit të Kupës së Shqipërisë ndaj Tiranës megjithatë kjo fitore nuk i ka mjaftuar asaj për të kaluar në turin tjetër të këtij kompeticioni. Kjo ngaqë kundërshtari kishte shënuar një gol më shumë në fushën e tij dhe për këtë arsye, është ai që kualifikohet për shkak të golaverazhit më të mirë. Vllaznia luajti në këtë ndeshje me plot pesë mungesa në formacion. Pjeshka, Marku, Hasani, Bardulla dhe Atsina, kanë qenë të pamundur për arsye dëmtimesh dhe padyshim që kjo gjë do të ndikonte në njëfarë mënyrë në lojën e kuqeblove. Golin e vetëm të ndeshjes do ta shënonte Kalaja në pjesën e dytë ndërkohë që nuk kanë munguar edhe disa raste të tjera shënimi por futbollistët vendas kanë qenë të pafat. Në disa momente ata janë ndalur edhe nga disa vendime jo të drejta të arbitrit anësor që sinjalizoi disa pozicione jashtë-loje të paqena. Gjithsesi, Vllaznia tashmë duhet të fillojë të mendojë vetëm për ndeshjen e rradhës të kampionatit, atë që do të luajë të shtunën në Shkodër ndaj Kamzës.

© vllaznia.al